

NJOFTIM

Për kandidatët që do të zhvillojnë intervistën me gojë për pozicionin e punës :

“Specialist i vjeljes së pagesave dhe arkëtimeve”- AKEP

Procedura : **LEVIZJE PARALELE NE KATEGORINE EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të Vendimit Nr. 243, datë 18.3.2015 “Për Pranimin, Lëvizjen Paralele, Periudhën e Provës dhe Emërimin në Kategorinë Ekzekutive”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) njofton se pas vlerësimit paraprak të kandidatëve:

Zj. ANJEZA RAMOHITAJ

do të vazhdojnë konkurimin, në procedurën levizje paralele në kategorinë ekzekutive.

Konkurimi

Konkurimi - Intervista me gojë do të zhvillohet në ambientet e QKMF të AKEP(salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, Nr.43, mbrapa bar restorant la voglia në datën **20.03.2017** ora **13:00**.

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komisioni i Brëndshem i ngritur në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnime dhe kualifikime në fushën përkatëse, si dhe 10 pike për certifikimin pozitiv.
- b. **60 pikë** për intervista me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **“Specialist i vjeljes së pagesave dhe arkëtimeve”**.

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 13, Kreu IV të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, levizjen paralele, periudhen e proves dhe emerimin në kategorine ekzekutive”.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të shpallet në datën **21.03.2017**.

Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **22.03.2017**

Njesia Përgjegjëse

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)